3

Arrestohet në kufi me Maqedoninë nënkryetari i PD-së së Dibrës, kërkohej për sulmin ndaj KZAZ

4

Kosovë/ Pas dorëheqjes së Isa Mustafës, kryetari i ri i LDK-së zgjidhet Lumir Abdixhiku

5

Lumir Abdixhiku kryetari i ri i LDK-së, Basha: Pres me kënaqësi të punoj me të, do e çoj bashkëpunimin para

Aktualitet

Shkodra s'gjen qetësi! Sherr në lokal, plag ! E ëma: Me autorin u konfliktuan 1 javë m e tavolina, sot e qëlloi bashkë me shokët

Shkodra nuk gjen qetësi! Pas plagosjes së dy vëllezërve Hoten dhe Marjan Doci një natë më parë në njen e sotme është plagosur me armë zjarri në këmbë 22 vjeçari Mikel Fusha, në lagjen Mark Lula.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

- Shkak i sherrit një konflik në lokal! Identifikohet autori, ende në arrati
- I riu u qëllua në këmbë, jashtë rrezikut për jetën! Ky është lokali ku ndodhur sherri
- Shkodër/ 22 vjeçari punon në lokalin ku u plagos! E ëma s'ndal britmat: Romina si ka qenë puna
- Nëna e Mikel Fushës: Shkuam 1 javë më parë te familja e autorit dhe iu thamë ta largonin djalin
- Atentat me armë zjarri në Shkodër, mbeten të plagosur 2 vëllezërit Doçi, 23 dhe 30 vjeç! Lidhje familjare me 'trurin' e pengmarrjes së Jan Prengës në Kamëz! Identifikohet autori

Redaksia
21 Mars, 19:41 | Përditesimi i fundit: 22 Mars, 00:45

Shkodra nuk gjen qetësi! Pas ***plagosjes*** së dy vëllezërve Hoten dhe Marjan Doci një natë më parë në fshatin Bardhaj, si pasojë e një sherri në një lokal mbrëmjen e sotme është plagosur me armë zjarri në këmbë 22 vjeçari Mikel Fusha, në lagjen Mark Lula.

22 vjeçari ka qenë në lokalin ku ai punonte kur autori i dyshuar Elvis Lekëndreu, ka shkuar dhe e ka qëlluar me armë pasi kanë bërë sherr. Pasi ka plagosur Mikel Fushën, autori është larguar nga vendi i ngjarjes ndërsa policia është vënë në ndjekje të tij.


LEXO EDHE:
Topalli nis fushatën: Duhet të kishim bërë më shumë për Shkodrën! Kush e mendon Ramën ose Bashën Kryeminister pas 25 prillit ai qoftë

Dyshohet se shkak i plagosjes ka qenë një konflikt i nisur mes 22 vjeçarit dhe autorit, një javë më parë po në këtë lokal. E ëma e të riut të plagosur thotë se një javë më parë autori ka shkuar në lokalin ku punon djalit i saj dhe duke thyer karrige e tavolina e duke e kërcënuar.

Menjëherë pas kësaj ngjarjeje ajo ka shkuar në shtëpinë e Elvis Lekëndreut dhe u ka kërkuar familjarëve të tij ai të mos i binte më në qafë djalit të saj. Por kjo thirrje ka shkuar në vesh të shurdhër sepse pas një jave, Lekëndreu ka shkuar në lokal bashkë me shokët e tij dhe plagosi Mikel Fushën i cili ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

Në vendngjarje ndodhet grupi hetimor dhe nën drejtimin e Prokurorisë po vijon puna për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes.

"*Më datë 21.03.2021, rreth orës 19:30, në lagjen "Mark Lula", Shkodër, dyshohet se pas një konflikti të çastit është plagosur në këmbë me armë zjarri shtetasi M. F, 22 vjeç, i cili ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Nga veprimet e para hetimore, dyshohet se autori i plagosjes është shtetasi E. L, ku vijon krehja e zonës për kapjen e tij*", thotë policia.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 20:23

Shkodër/ 22 vjeçari punon në lokalin ku u plagos! E ëma s'ndal britmat: Romina si ka qenë puna

E ëma e Mikel Fushës të riut që është plagosur sot në Shkodër me armë zjarri pas një sherri, ka shkuar pranë lokalit ku punon i biri dhe bërtet me të madhe emrin e një punonjëseje së cilës i kërkon që t'i tregojë si ka ndodhur ngjarja.

> *"Romina si ka qenë puna e djalit tim...", thotë ajo.*

Ora 20:12

Plagosja e të riut në Shkodër, identifikohet dhe shpallet në kërkim autori (Emri)

Elvis Lekëndreu është autori i plagosjes së Mikel Fushës mbrëmjen e sotme në Shkodër. Pas ngjarjes, ai është larguar dhe ende nuk është kapur nga policia.

Ora 20:05

Shkodër, nëna e Fushës: Autori dhe djali janë konfliktuar 1 javë më parë! Shkuam te familja e tij dhe i thamë ta largonin! Ai e plagosi sot bashkë me shokët

Nëna e Mikel Fushës, të riut që është plagosur me armë zjarri në një lokal në Shkodër thotë se djali i saj dhe autori janë konfliktuar 1 javë më parë. Ajo thekson se ka shkuar në shtë pinë e prindërve të tyre duke kërkuar që djali i tyre të qëndrojë larg.

> *"Autori dhe djali janë konfliktuar një javë më parë. Djali punon në lokal me një vajzë. Ka ardhur edhe para 1 jave ka thyer karriget e tavolinat e kanë nxjerrë jashtë. Kemi shkuar edhe te i ati për t'i thënë "mos m'i bini në qafë djalit". Sot paska ardhur me shokë dhe e ka plagosur", tha ajo.*

Ora 20:04

Plagosja në Shkodër, i riu u qëllua në këmbë, ndodhet jashtë rrezikut për jetën! Ky është lokali ku ndodhur sherri



Mikel Fusha është plagosur në këmbë. Ngjarja ka ndodhur në një lokal pas një sherri të çastit. Report Tv sjell pamje nga vendi ku ka ndodhur ngjarja. Bëhet fjalë për këtë lokal, ku punonte i plagosuri, Mikel Fusha. I riu është dërguar në spital dhe ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

Ora 19:56

Të shtënat me armë në Shkodër, plagoset Mikel Fusha! Shkak një konflik i çastit në lokal! Identifikohet autori

Si pasojë e të shtënave me armë, mësohet se ka mbetur i plagosur Mikel Fusha. Ai është plagosur në këmbë, teksa është identifikuar autori i ngjarjes dhe po punohet për arrestimin e tij. Dyshohet se shkak i plagosjes është një konflikt i çastit. I plagosuri ndodhet jashtë rrezikut për jetën në spitalin e Shkodrës.

Be.K./Shqiptarja.com

TAG: Shkoder | te shtena me arme | plagosje | plagosje me arme zjarri | Mikel Fusha | Elvis Lekëndreu

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Cila prej partive politike po i respekton masat anti-Covid gjatë fushatës elektorale?

PS | PD | Asnjëra

Komento

Komente

vjeshta: 22/03/2021 09:56
Dukagjinasit në Dukagjin,atje të shqyhen ndër vedi! Shkodra t'u kthehet njerëzve të sjellshëm!
Përgjigju

Shaljani: 21/03/2021 21:49
Ka zbrit krejt dukagjini në shkoder Cado boj nona e shkrete Si gjith nonat normal do ulerij Se mezor I ka rrit. Zoti u rujt sender shtet kena 30 vjet Njeloj ike në parti e vjen nje tjeter. Vec llafe jo pun
Përgjigju

> **Eri:** 22/03/2021 10:00
> Edhe i plagosuri nga dukagjini eshte o bos

Lajme të tjera

Aktualitet

Zjarr në vendparkimet pranë Bashkisë në Sarandë, shkak një shkëndijë elektrike
30 Mars, 22:07

Aktualitet

Pse nuk u vaksinua Bashkim Fino? Brataj: Nuk i kishte ardhur radha! Rakacolli: Askund nuk ka vaksina sa ka njerëz
30 Mars, 21:55

Aktualitet

Ndërron jetë nga COVID-19 njeriu që ndërtoi HEC-in e Komanit
30 Mars, 21:36

Aktualitet

DASH publikon raportin për vitin 2020: Mosndëshkimi problem serioz për Shqipërinë, dënimet e zyrtarëve të lartë sporadike
30 Mars, 21:34

Aktualitet

Kryemadhi shpërndan mesazhin e Leonardio Di Caprio për mbrojtjen e lumit Vjosë: Faleminderit, 25 prilli një betejë për të ardhmen
30 Mars, 21:25

Aktualitet

Gjendet i vdekur në kanal 55-vjeçari në Maliq, dyshohet se është rrëzuar aksidentalisht
30 Mars, 21:16

© 2011 - 2021 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje